



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AGE Group" Sh.P.K. të datës 06.02.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 03.02.2025 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-24-13316-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AGE Group" Sh.P.K. të datës 06.02.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 03.02.2025 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-24-13316-5-2-1.
- II. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AGE Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 06.02.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 03.02.2025 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës Flamurtari" me nr. të prokurimit 616-24-13316-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Sipas katalogut të ofruar specifikimit teknik për driten Halide ne si OE pjesmarrës kemi dorëzuar katalogun dhe specifikat për pozicion sipas kërkesës së Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës. Në katalogon e ofruar dhe në specifikimin teknik,

Komisioni vlerësues siç duket është lajthitur nga mesatarja orëve të punës për këtë produkt duke marrë kolonen e parë të "Service Life" ku paraqitet mesatarja e jetëgjatësisë së produktit "Average nominal Lifespan" pra mesatarja nominale e jetëgjatësisë. Pra, siç shihet edhe në foton e bashkangjitur më poshtë verehet qartë se produkti plotëson kërkesat e kërkuara nga AK prej 6000 orë punë. Kolona e fundit e "Service Life" në rreshtin e 5 "Lamp survival factor at 6000h" përshkruhet jetëgjatësia e kësaj llambe".


Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për këto arsye:

4. Katallogun nga prodhuesi me specifikat e kërkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

Katalogun që ju keni dërguar në ofertën e tuaj nuk përmban kërkesat e kërkuara në specifikimin teknik të kërkuar nga AK. Në specifikimin teknik në pozicionin nr. 12 është kërkuar: Llambe halide metalike me jetëgjatësi 6000 ore pune. OE AGE group shpk në katalogun e tij ka ofruar dritën halide metalike me jetëgjatësi prej 4500 ore pune.

Sa i përket pretendimeve ankimore është gjetur se nuk është kontestues fakti që në DT është kërkuar Llampë halide metalike me jetëgjatësi së paku 6000 orë pune. Ndërsa parashtruesi në katalogun e dorëzuar ka prezantuar llampën me parametrat si vijon:

Metal halide lamp with quartz burner
HRI-TS 2000W/D/S/400/K12S



A+



210000



6100K



4 500h

Service Life

Average nominal lifespan	4500 h
B5 - Service life 5% failures	1800 h
Lamp survival factor at 2000h	0.94
Lamp survival factor at 4000h	0.76
Lamp survival factor at 6000h	0.47

Pra parametrat e llampës me të cilat ka ofertuar parashtruesi janë më të ultë sesa parametrat e kërkuar në DT për pajisjen përkatëse pasi që jetëgjatësia e llampës së prezantuar është vetëm 4500 orë dhe jo së paku 6000 orë. Argumentimi i parashtruesit se në rastin konkret kemi të bëjmë "jetëgjatësinë mesatare të llampës" është argument i pabazuar. Kjo pasi që jetëgjatësia është kërkuar të jetë 6000 orë dhe kur themi se jetëgjatësia mesatare është 4500 orë atëherë kjo nënkupton që zakonisht (pra mesatarisht) jetëgjatësia e llampës është dukshëm më e vogël sesa 6000 orë. Ngjashëm vlen edhe për argumentin tjetër të parashtruesit ku thuhet se jetëgjatësia e llampës është përshkruar në pikën 5 të paragrafit service life ku përcaktohet "lamp survival factor at 6000h" (faktori i mbijetesës së llampës). Kjo për arsye se në këtë paragraf përcaktohet se faktori mbijetues i llampës në 2000 orë është 0.94, pastaj faktori mbijetues në 4000 orë është 0.76 ndërsa faktori mbijetues i llampës në 6000 orë është shumë më i ulët vetëm 0.47. Pra nga cilido këndvështrim i mundshëm jetëgjatësia e llampës së prezantuar nga parashtruesi nuk e arrin jetëgjatësinë prej 6000 orëve sikurse është kërkuar përmes dosjes së tenderit.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.02.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.